



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2585, datë 10.07.2015

Për

Shyrtimin e propozimit të inspektorëve për heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj.Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj.Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj.Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.07.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr. 2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shyrtimin e propozimit të inspektorëve për heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k.

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
3. Rregullore e AKEP nr. nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative”,

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Urdhër Inspektimi nr. 1047Prot., datë 15.5.2015, për inspektim të sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k.;
2. Akti i Inspektimit nr. 13, datë 27.5.2015 (nr. 1047/1Prot., datë 27.5.2015);
3. Relacion mbi inspektimin e kryer tek sipërmarrësi i komunikimeve elektronike Hysa 2008 sh.p.k.;
4. Korrespondenca me postë elektronike e shkëmbyer mes palëve;
5. Memo drejtuar Kryetarit, më datë 28.5.2015, përgatitur nga DMFCI “Mbi rezultatet e inspektimit”;
6. Shkresa nr. 1047/4Prot., datë 19.6.2015, për thirrje në seancë dëgjimore të Hysa 2008 sh.p.k.
7. Relacion shpjegues (Relacioni);

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

I.

1. Me Urdhrin e Inspektimit nr. 1461Prot., datë 15.5.2015, Kryetari ka udhëruar kryerjen e inspektimit në sipërmarrësin e komunikimeve elektronike Hysa 2008 sh.p.k., me objekt verifikimin e zbatimit të:
 - i. Kushteve të përcaktuara në Autorizimin e përgjithshëm lidhur me:
 - *Bashkëveprimin e shërbimeve dhe interkoneksionin e rrjeteve;*
 - *Sigurimin e disponueshmërisë dhe përdorimin e numrave nga plani i numeracionit për përdoruesit fundorë;*
 - *Mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe të privatësisë;*
 - *Mbrojtjen e përdoruesve;*
 - *Respektimin e rasteve të kufizimeve në lidhje me përmbajtjen e paligjshme ose të dëmshme;*
 - *Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente;*
 - *Ofrimin e rrjeteve të komunikimeve publike në rastet e gjendjes së emergjencës;*
 - *Detyrimi për të ofruar akses;*
 - *Mbrojtjen e rrjeteve të komunikimeve publike ndaj aksesit të paautorizuar;*
 - *Detyrimin për të plotësuar standardet dhe specifikimet teknike të rrjeteve dhe të pajisjeve për ndërtimin e rrjeteve dhe ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike si dhe të shërbimeve të faciliteteve shoqëruese;*
 - *Regjistrimin e pajtimtarëve, ruajtjen dhe administrimin e të dhënave për qëllime të ndjekjes penale, etj;*
 - ii. Kushteve të përcaktuara në Autorizimin Individual për përdorimin e frekuencave;

- iii. Kushteve të përcaktuara në aktet normative të AKEP lidhur me:
- a. *Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve;*
 - b. *Kushteve të përgjithshme të kontratave tip me pajtimtarin.*
2. Në zbatim të urdhrimit të lartpërmendur, grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht me telefon dhe me anë të postës elektronike më datë 21.5.2015, përfaqësuesin e sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k., të cilit i ka dërguar bashkëngjitur kopje të urdhrimit. Gjithashtu, përfaqësuesit i është kërkuar krijimi i kushteve për kryerjen e inspektimit, konform nenit 12, të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2014 për “Inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” (këtu e më poshtë: *rregullore e inspektimit*). Përfaqësuesi i Hysa 2008 sh.p.k., nuk i është përgjigjur këtij emaili dhe as telefonatave të kryera nga inspektorët e AKEP. Grupi i inspektimit, gjatë kryerjes së inspektimit nuk është shoqëruar nga ky përfaqësues.
3. Në përfundim të verifikimit të zbatimit të detyrimeve të sipërmarrësit, dhe duke patur parasysh dokumentacionin e dorëzuar në AKEP në zbatim të rregullore dhe ligjit nr. 9918, i ndryshuar, inspektorët kanë konstatuar se:
1. Sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k. sipas Autorizimit Nr. 2012-AP-U249-8-1, datë është regjistruar për të ofruar:
 - A. *Rrjete publike të komunikimeve elektronike:*
 - a. *Rrjete publike tokësore fikse aksesit dhe transmetimi*
 - B. *Shërbimeve publike të komunikimeve elektronike:*
 - b. *Shërbime telefonike / Aksesit në internet etj.*
 2. Grupi i inspektimit pas verifikimit, ka konstatuar se, sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k.:
 - a. nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9918, i ndryshuar, dhe konkretisht nenin 132, pika 3, që parashikon lejimin dhe bashkëpunimin e sipërmarrësit me inspektorët e AKEP gjatë procesit të inspektimit si dhe,
 - b. nuk ka zbatuar kërkesat e rregullores nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve”.
 3. Për këto shkelje inspektorët, bazuar në nenin 135, pika 2, gërma b, e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, dhe nenin 33, (nënpika 33.2, gërma d) mbi kundravajtjet administrative, të Rregullores së inspektimit, kanë vendosur t’i propozojnë Këshillit Drejtues të AKEP, heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike, sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k.

II.

Pas shqyrtimit të materialeve pjesë përbërëse të dosjes së inspektimit, konstatimeve dhe konkluzioneve të arritura në përfundim të procesit të inspektimit, vlerëson se:

1. Grupi i inspektimit në zbatim të parashikimeve të Rregullores nr. 34, datë 23.12.2015, për inspektimin, monitorimin e spektrit të frekuencave dhe masat administrative” dhe konform këtyre kërkesave të rregullores, ka kryer veprimet proceduriale duke zhvilluar procedurë inspektuese.
2. Rezulton se, Grupi i inspektimit ka njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k., me telefon dhe postë elektronike më datë 21.5.2015, duke i ka dërguar bashkëngjitur kopjen e Urdhrit të Inspektimit nr. 1461Prot., datë 15.5.2015.
3. Përfaqësuesi i Hysa 2008 sh.p.k. rezulton të mos i jetë përgjigjur grupit të inspektimit dhe mos ketë bashkëpunuar me këta të fundit, në zbatim të detyrimit të parashikuar në nenin 132, pika 3 e ligjit nr. 9918, dhe Rregullores së inspektimit nr. 34, datë 23.12.2015, nenit 5 (pika 5.4) dhe nenit 10 për të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e sipërmarrëve gjatë inspektimit të veprimtarisë së tyre.
4. Sa i takon shkeljeve të tjera konstatuara nga inspektorët gjatë verifikimit, vërehet se, sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k., edhe pse është njoftuar disa herë nga strukturat e posaçme të AKEP të ngarkuara për zbatimin e detyrimeve rregullatore, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga Rregullorja nr. 27, datë 21.9.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve“.
5. Mospërbushja nga sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k., e detyrimeve të rregullores nr. 27, përbën gjithashtu, shkelje të parashikimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, e konkretisht nenin 54, detyrimin mbi publikimin e tarifave për përdoruesit fundorë, dhe nenin 98, mbi transparencën dhe publikimin e informacionit.
6. Në njoftimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të AKEP, rezulton se sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k., i është lënë afat për përmbushjen e detyrimeve, mbi publikimin e të dhënave në faqen e internetit afat i cili nuk është respektuar, duke cuar në mosplotësimin e detyrimit për dërgimin e të dhënave konform Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm dhe rregulloreve të tjera të lartpërmendura.
7. Për sa më lart u shpjegua, Këshillit Drejtues, në zbatim të nenit 135, pika 4, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, i ndryshuar, vendosi të thërrasë në seancë dëgjimore sipërmarrësin Hysa 2008 sh.p.k., për t’i dhënë mundësi të japë shpjegime, përpara marrjes së vendimit nga Këshilli Drejtues.
8. Me shkresën nr. 1047/4Prot., datë 19.6.2015, të Këshillit Drejtues, sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k., është njoftuar për mbajtjen e seancës dëgjimore më datë 24.6.2015, ora 10:00, në lidhje me përfundimet e aktit të inspektimit.
Në datën dhe orën e caktuar, pranë AKEP, nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga Hysa 2008 sh.p.k. Gjithashtu, nuk është depozituar njoftim në lidhje me arsyet e

mospjesëmarrjes. Nga zyra e protokollit deri më datë 29.6.2015 nuk rezulton të jetë kthyer shkresë nga zyra postare.

9. Në përfundim të arsyetimit dhe për sa më lart parashtruam, duke patur parasysh, shkeljet e konstatuara, rrethanat në të cilat është zhvilluar veprimtaria inspektuese dhe verifikuese sipas objektit të Udhrit, në kushtet e mosbashkëpunimit të sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k., duke çuar në mospërbushjen e detyrimeve edhe pas njoftimeve nga AKEP, dhe së fundi mosparaqitja në seancën dëgjimore të datës 24.6.2014, të njoftuar nga Këshilli Drejtues, pa shkak të arsyeshëm,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 dhe pikën 3 / b të nenit 135, të ligjit nr. 9918/2008 të ndryshuar, dhe në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S:

1. Të miratojë propozimin e inspektorëve për heqjen e së drejtës së ofrimit të shërbimeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike sipërmarrësit Hysa 2008 sh.p.k.
2. Të njoftohet sipërmarrësi Hysa 2008 sh.p.k. për zbatimin e këtij Vendimi;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Tiranës, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**